

PROCESVERBAL 23/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 8 (tetë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 23.08.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;

4.Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Denis Sofra - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që është marrë një vendim paraprak për ta lejuar komunën që të themeloj komisionin që ti zhvilloj këto procedura.Bëhet fjalë për 4 banesat e komunës që janë te ndërtesa e kaltërt.

Denis Sofra - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;

Avni Bytyqi - bëhet fjalë për këmbimin e pronës publike me pronën private e cila është te rruga “Luigj Nikolla” në hyrje të Suharekës.Para tre muajve komuna e ka shpall zonë me interes të përgjithshëm pronën private dhe ne sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale i kemi ndjek të gjitha procedurat deri në marrjen e vendimit duke bë vlerësimin e pronës.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Denis Sofra - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Të ndryshme

Nazim Shabanaj - këta që po merren me ndihma sociale për fëmijë, a ka mundësi me i ndihmu me qanta dhe libra?

Avni Bytyqi - besoj që DKA ka me bë një listë për ata persona që kanë nevojë dhe nëse ka mundësi komuna ka me i subvencionu.

Nazim Shabanaj - u cek edhe në KKSB që i marrin prindërit paret për libra mirëpo ata s'kanë ndihma dhe ato pare i hargojnë dhe nuk i blejnë librat për fëmijët.

Denis Sofra - unë jam duke e bë asistimin për tekstet shkollore dhe pothuaj 80% të komuniteteve jam duke e kry. Aty është një deklaratë ku deklaron prindi që ato mjete kanë me u shfrytëzu për libra. Ato pare kur të merren, secila familje duhet me kontaktu me mësuesin për libra dhe paret ose ia dërgojnë mësuesit dhe mësuesi i porosit librat dhe i merr. Nëse mësuesit nuk angazhohen atëherë prindërit e marrin listën e librave nga shkolla dhe i blejnë vet librat.

Avni Bytyqi - besoj DKA nuk është i interesuar me i lënë nxënësit pa libra por ka prind të atillë që janë të papërgjegjshëm.

Takimi përfundoi: 09:10